

**BANKA KOMERCIALE SHA SHKUP**

**RREGULLORE**

**e punës së Këshillit mbikëqyrës të Bankës Komerciale SHA Shkup**

**Shkup, prill 2011**

## **PROPOZIM**

Në bazë të nenit 72 të Statutit të Bankës Komerciale SHA Shkup, Këshilli mbikëqyrës i Bankës, në mbledhjen e tij të 40-të, të mbajtur më 28.04.2011, miratoi

### **RREGULLOREN e punës së Këshillit mbikëqyrës të Bankës Komerciale SHA Shkup**

#### **I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë Rregullore rregullohet mënyra e punës dhe vendimmarrjes, si dhe çështje të tjera të lidhura me Punën e Këshillit mbikëqyrës të Bankës Komerciale SHA Shkup (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshilli mbikëqyrës)

##### **Neni 2**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të detyrueshme për anëtarët e Këshillit mbikëqyrës dhe për personat tjerë, të cilët marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës.

##### **Neni 3**

Këshilli mbikëqyrës merr vendime në mbledhje dhe pa mbajtjen e mbledhjes, sipas kushteve në pajtim me ligjin, Statutin dhe aktet tjera të Bankës.

##### **Neni 4**

Për punët e fushëveprimit të tij, Këshilli mbikëqyrës mund të formojë një ose më shumë komisione nga radhët e anëtarëve të tij dhe nga persona të tjerë.

##### **Neni 5**

Gjatë mbledhjeve, Këshilli mbikëqyrës punon në bazë të ligjit, Statutit dhe akteve të tjera të Bankës.

##### **Neni 6**

Në seancën e parë konstitutive, anëtarët e Këshillit mbikëqyrës, nga radhët e veta zgjedhin Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e Këshillit mbikëqyrës.

Seancën e parë konstitutive e thërret dhe me të deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit, udhëheq anëtari i Këshillit mbikëqyrës me moshë më të vjetër.

Kandidatët për Kryetar dhe Zëvendëskryetar zgjidhen nëpërmjet votimit publik.

Për Kryetar dhe Zëvendëskryetar i zgjedhur konsiderohet ai që ka fituar shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës.

Mandati i Kryetarit, Zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës zgjat 4 (katër) vjet.

## **II KOMPETENCAT**

### **Neni 7**

Në pajtim me rregullat ligjore dhe nënligjore, Statutin dhe aktet e brendshme të Bankës, Këshilli mbikëqyrës i kryen punët në vijim:

1. aprovon politikën afariste dhe planin afarist të Bankës,
2. emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit drejtues të Bankës,
3. emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit për menaxhim me rrezikun,
4. emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit kreditor të Bankës,
5. emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit për mbikëqyrjen e teknologjisë informatike,
6. miraton planin financiar të Bankës,
7. miraton instalimin dhe organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndjek efikasitetin e tij,
8. shqyrton raportin e Këshillit drejtues lidhur me vendosjen dhe efikasitetin e kontrollit të brendshëm,
9. organizon Shërbimin e revizionit të brendshëm dhe emëron dhe shkarkon të punësuarit,
10. miraton planin vjetor të Shërbimit të auditit të brendshëm,

11. miraton Politikën e sigurisë së sistemit informativ,
12. miraton politikën e sigurisë së sistemit informativ, kryen vlerësimin e përshtatshmërisë së tij, së paku njëherë në vit në aspekt të ndryshimeve të ndodhura në strukturën organizative dhe ndryshimeve në sistemin informativ të Bankës,
13. ndjek efikasitetin e procesit të drejtimit të sistemit informativ, nëpërmjet analizës së rezultateve nga testimi i kontrolleve të sigurisë të vendosura në sistemin informativ,
14. miraton politikat e menaxhimit me rrezikut në Bankë dhe ndjek zbatimin e tyre,
15. miraton planet dhe programet e punës dhe aktet e përgjithshme të Bankës, përveç akteve që i miraton Kuvendi i Bankës,
16. shqyrton raportet e punës së Këshillit drejtues të Bankës,
17. shqyrton raportet e punës së Këshillit për menaxhimin me rrezikun,
18. shqyrton raportet e Këshillit të revizionit,
19. shqyrton raportet e kontrollit të përputhshmërisë së punës së Bankës me rregulloret,
20. miraton llogarinë vjetore dhe raportet financiare të Bankës,
21. miraton listën e borxhlinjve neto të Bankës,
22. miraton ekspozimin ndaj personit të caktuar të mbi 10% nga mjetet vetanake të Bankës,
23. miraton vendim për çdo ekspozim, me të cilën ekspozimi i përgjithshëm kundrejt individit i tejkalon 15% dhe 20% nga mjetet vetanake të Bankës,
24. miraton transaksione me persona të lidhur me Bankën në shumën mbi 1.000.000 denarë,
25. miraton të drejtën e përfitimit të pjesëve kapitale dhe blerjen e letrave me vlerë, të barabarta ose më të mëdha se 5% të mjeteve vetanake të Bankës, përveç blerjes së letrave me vlerë të lëshuara nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,
26. miraton propozimin e Këshillit të revizionit për emërimin e shoqërisë së revizionit dhe është përgjegjës për sigurimin e revizionit adekuat,

27. miraton politikat dhe procedurat për kryerjen e auditimit të brendshëm, kryen mbikëqyrje të harmonizimit të procedurave dhe efikasitetin e punës së Shërbimit të auditit të brendshëm dhe shqyrton raportet e tij,
28. shqyrton raportet e supervizionit, raporte të tjera të miratuara nga Banka Popullore, Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe institucione të tjera kompetente dhe propozon, përkatësisht ndërmerr masa dhe aktivitete për tejkalimin e mospërputhshmërive dhe pikave të dobëta në punën e Bankës,
29. shqyrton procesverbalet nga kontrolli i drejtpërdrejt nga terreni dhe inspektimi i Bankës Popullore. Në Bankën Popullore dorëzon procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës, ku shqyrtohen procesverbalet nga kontrolli dhe verifikon vërejtjet e Bankës në procesverbalin e saj,
30. miraton raportin vjetor të punës së Bankës dhe dorëzon mendim të shkruar për raportin deri te Kuvendi i Bankës,
31. shqyrton raportin e shoqërisë së revizionit dhe dorëzon mendim me shkrim për të njëjtin deri të Kuvendi i Bankës,
32. jep mendim me shkrim deri te Kuvendi i Bankës lidhur me raportin vjetor të Shërbimit të kontrollit të brendshëm,
33. dorëzon raportin vjetor të Shërbimit të auditit të brendshëm deri te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,
34. miraton Kodeksin e etikës së Bankës,
35. miraton Rregulloren e punës së Këshillit të auditit,
36. i dorëzon raport Kuvendit për punën në aspektin individual dhe kolektiv të anëtarëve,
37. vendosë për lëshimin e letrave me vlerë, përveç aksioneve dhe letrave të tjera me vlerë konvertibile në aksione,
38. me akt të veçantë e përcakton mënyrën dhe kushtet e botimit të derivateve financiare,
39. i propozon Kuvendit lëshimin e aksioneve,
40. miraton raportin e regjistrimit të mjeteve dhe burimeve të mjeteve,

41. vendosë për huamarrjet e Bankës dhe marrjen e kredive mbi 5% të mjeteve vetanake të Bankës, përveç për huamarrjet e likuiditetit të Bankës,
42. vendosë për fshirje të pjeshme ose të tërësishme të kërkesave problematike,
43. shqyrton raportin e kërkesave, tek të cilat është realizuar shtyrje e afatit të maturimit, njëherë në muaj,
44. shqyrton raportin e kërkesave të ristrukturuara, njëherë në muaj,
45. vendosë për nënshtrimin kreditor të personit të caktuar dhe për personat e lidhur me të, në kuadër të limiteve të përcaktuara me aktet e Bankës,
46. vendosë për blerjen, shitjen dhe marrjen me qira të mjeteve themelore të Bankës, mbi 250.000 EUR,
47. vendosë për fitimin dhe disponimin e pronës në bazë të kërkesave të papaguara të Bankës në pajtim me aktet e Bankës,
48. shqyrton raportet për llojin dhe shumën e mjeteve të marra në bazë të kërkesave të papaguara, aktivitetet e ndërmarra për shitjen e tyre dhe statusin e realizimit të planeve për shitje dhe/ose ndryshimet në planet e shitjes, si dhe shumën e shitjes së mjeteve të marra, më së paku në baze tremujore,
49. vendosë për anëtarësimin në organizata financiare dhe të tjera, për lidhjen e marrëveshjeve, etj.,
50. miraton akte të përgjithshme për kushtet më të ngushta për dhënien e kredive të caktuara, ristrukturimin e kërkesave, konversionin e kredive, avilimin dhe eskontimin e kambialeve dhe kërkesave e garancive të tjera,
51. miraton propozimin e Këshillit drejtues për caktimin e mbajtjes së Kuvendit vjetor,
52. cakton mbajtjen e Kuvendit të Bankës ndërmjet dy kuvendeve vjetore, me iniciativë vetanake ose me kërkesë të aksionarëve,
53. miraton propozimin e Këshillit drejtues për caktimin e mbajtjes së Kuvendit vjetor dhe jep mendim deri te Këshilli drejtues për thirrjen e Kuvendit sipas iniciativës së aksionarëve,
54. ndjek ekzekutimin e vendimeve, përfundimeve dhe orientimeve të miratuara në Kuvendin e Bankës,

55. bën inspektimin e vendimeve të miratuara në bazë të pajtimit me shkrim të anëtarëve ndërmjet dy seancave,
56. aprovon, përkatësisht verifikon vendimet e miratuara nga organet e Bankës në rastet kur e njëjta është e parashikuar me rregulloret ligjore dhe nënligjore, ose aktet e Bankës,
57. vendosë në shkallën e dytë sipas vendimit të punëtorëve të pakënaqur, ose sipas vërejtjeve për rishikimin e vendimit të tij,
58. aprovon ndryshimet thelbësore organizative të brendshme në Bankë, të cilat janë të dedikuara për themelimin e sektorëve të rij, apo drejtorive të pavarura,
59. sjell vendim për ndarjen e përgjegjësive ndërmjet anëtarëve të Këshillit drejtues të Bankës,
60. aprovon aktin e Këshillit drejtues, me të cilin rregullohet përfaqësimi dhe nënshkrimi i akteve të Bankës,
61. bën vlerësimin e punës së Këshillit drejtues të Bankës dhe propozon shpërblim eventual të Këshillit drejtues, së paku njëherë në vit,
62. në periudhë gjysmëviti bën vlerësimin e efikasitetit të punës vetanake,
63. çdo tre muaj shqyrton raportin e transaksioneve të personave të asocuar me Bankën, si dhe për shumën e përgjithshme të kredive të aprovuara dhe formave të tjera të drejtnënshtimit të të punësuarve të tjerë në Bankë,
64. aprovon Politikën e identifikimit të konflikteve të interesit,
65. aprovon Programin e pengimit të korrupsionit,
66. miraton Politikën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit drejtues, personave me të drejta dhe përgjegjësi të posaçme, të cilët kryejnë funksione udhëheqëse dhe të punësuarve në Bankë,
67. miraton Kodeksin e udhëheqjes korporatave dhe më së paku një herë në vit, gjatë rishikimit të Kodeksit,
68. aprovon Politikën e zbatimit efikas dhe të përhershëm të kontrollit të përputhshmërisë së punës së Bankës me rregulloret,
69. aprovon strategjinë e marrjes dhe menaxhimit me rrezikun dhe ndjek realizimin e saj,

70. vlerëson përputhshmërinë e strategjisë së miratuar dhe politikave për administrimin e rreziqeve së paku njëherë në vit,
71. shqyrton raportet e profilit të rrezikut të Bankës,
72. aprovon limitet e nënshtrimit të llojeve të caktuara të rreziqeve,
73. miraton instalimin e produkteve të reja, që kanë ndikim të rëndësishëm ndaj profilit të rrezikut të Bankës,
74. aprovon Politikën e shpalljes së raporteve dhe të dhënave nga Banka,
75. aprovon Politikën e menaxhimit me rrezikun kreditor, ndjek realizimin dhe përshtatshmërinë e saj, së paku njëherë në vit,
76. aprovon Politikën e identifikimit, matjes, ndjekjes dhe kontrollit të rrezikut valutor dhe shqyrton përshtatshmërinë e saj, së paku njëherë në vit,
77. me propozim të Këshillit për menaxhim me rrezikun e përcakton formën, përmbajtjen dhe dinamikën e lajmërimeve të Këshillit mbikëqyrës për aktivitetet e Bankës në valutë dhe në denarë me klauzolë bankare,
78. aprovon Politikën e udhëheqjes me rrezikun e likuiditetit, ndjek realizimin e saj dhe përshtatshmërinë, së paku njëherë në vit,
79. shqyrton raportet e rrezikut të likuiditetit,
80. bën punë të tjera në pajtim me rregullat ligjore dhe nënligjore, Statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të Bankës,

### **III MËNYRA E PUNËS DHE VENDIMARRJA**

#### **1. përgatitja dhe thirrja e seancës,**

##### **Neni 8**

Mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës mbahen sipas nevojës, por së paku njëherë në vit,

Seancat e Këshillit mbikëqyrës i thërret dhe me to udhëheq Kryetari i Këshillit mbikëqyrës, kurse në mungesë të tij Zëvendëskryetari,



Mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës thirren edhe sipas kërkesës së 1/3 të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, ose sipas kërkesës së Këshillit drejtues të Bankës.

Propozimin për rendin e ditës për mbledhjet e verifikon Kryetari i Këshillit mbikëqyrës dhe në mungesë të tij Zëvendëskryetari.

### **Neni 9**

Anëtarët e Këshillit me shfrytëzimin e lidhjes së konferencës, lidhjes telefonike ose më shfrytëzimin e pajisjeve audio apo vizuale mbikëqyrës mund të marrin pjesë dhe vendosin në seanca të organizuara

Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës mund të marrin pjesë dhe vendosin edhe në mbledhje të organizuara me shfrytëzimin e lidhjes telefonike, video-konferencave ose me shfrytëzimin e pajisjeve të tjera audio vizuale të komunikimit, ku të gjithë pjesëmarrësit e mbledhjes dëgjohen, shihen dhe flasin njëri me tjetrin.

### **Neni 10**

Thirrja e mbledhjes së Këshillit mbikëqyrës bëhet me ftesë me shkrim të nënshkruar nga kryetari dhe në mungesë të tij të nënshkruar nga Zëvendëskryetari ose me ftesë në formë elektronike të dërguar me postë elektronike.

Në ftesë shënohet dita, ora dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes, si dhe rendi i ditës.

Në raste urgjente, ftesa për mbajtjen e mbledhjes mund të dërgohet edhe me faks, ose të komunikohet me telefon.

### **Neni 11**

Përkrah anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, në mbledhje ftohen edhe anëtarët e Këshillit drejtues të Bankës.

Në mbledhje mund të ftohen dhe persona të tjerë profesionist të njësive organizative të Bankës, me ç'rast nga fushëveprimi i të cilëve, në rendin e ditës, përfshihen edhe pyetje për shqyrtim. Për pjesëmarrjen e këtyre profesionistëve, vendosë Kryetari i Këshillit mbikëqyrës dhe i Këshillit drejtues të Bankës.

### **Neni 12**

Materialet së bashku me ftesën dorëzohen më së voni 5 (pesë) ditë para mbajtjes së mbledhjes, por me përjashtime mund të dërgohen edhe në afat më të shkurtër.

Në raste të veçanta, materialet mund të dorëzohen edhe gjatë mbajtjes së mbledhjes, nëse shqyrtimi i tyre dhe vendosja për to nuk mund të shtyhet dhe për këtë vendosë Këshilli mbikëqyrës.

Pas marrjes së materialeve të mbledhjes, anëtari i Këshillit mbikëqyrës nëse nuk ka mundësi të merr pjesë në mbledhje, me shkrim mund ta bëjë të ditur mendimin e tij përkitazi me materialet, por nuk mund të votojë për pikat e rendit të ditës.

## **2. Rrjedha e seancës**

### **Neni 13**

Seancën e Këshillit mbikëqyrës e hap dhe me të udhëheq Kryetari i Këshillit mbikëqyrës, kurse në mungesë të tij Zëvendëskryetari.

Pas hapjes së seancës, kryetari i Këshillit mbikëqyrës verifikon se a ka shumicë të anëtarëve për të marrë vendime të plotfuqishme.

Këshilli mbikëqyrës me të drejtë të plotë diskuton dhe vendosë nëse në seancë janë të pranishëm shumica, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës.

Nëse në mbledhjen e Këshillit mbikëqyrës nuk ka shumicë për vendimmarrje të plotfuqishme, mbledhja shtyhet dhe caktohet në afat jo më të gjatë se 3 (tri) ditë nga dita e shtyrjes.

### **Neni 14**

Këshilli mbikëqyrës sipas propozimit të Kryetarit dhe në mungesë të tij, të Zëvendëskryetarit, para fillimit të mbledhjes e verifikon rendin e ditës së mbledhjes.

### **Neni 15**

Rendi i ditës i mbledhjes mund të ndryshohet dhe plotësohet.

Nëse çështjet, me të cilat plotësohet rendi i ditës nuk kërkojnë analizë të posaçme dhe dorëzim të materialeve plotësuese, shqyrtohen dhe për të njëjtat vendoset në të njëjtën mbledhje.

Këshilli mbikëqyrës mund të vendosë që çështje të caktuara të shtyhen për shkak të analizës dhe dorëzimit të materialeve për mbledhjen e ardhshme.

## **Neni 16**

Pas hapjes së mbledhjes, procesverballi nga mbledhja e kaluar vendoset në shqyrtim, me qëllim që anëtarët e Këshillit mbikëqyrës, të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në mbledhjen paraprake, të njihen me punën e Këshillit mbikëqyrës të asaj mbledhjeje.

## **Neni 17**

Shqyrtimi i materialeve me rregull bëhet sipas renditjes në rendin e miratuar të ditës.

Diskutimin për pikat e rendit të ditës e hapë Kryetari i Këshillit mbikëqyrës, përkatësisht Zëvendëskryetari.

Diskutimi udhëhiqet sipas pikave të rendit të ditës, derisa ato nuk përfundojnë.

## **Neni18**

Në diskutim kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit mbikëqyrës.

Me kërkesë të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, në diskutim, mund të marrin pjesë edhe persona të tjerë të ftuar nga shërbimet profesionale të Bankës dhe të njëjtët janë të detyruar të japin sqarime për materialet e caktuara.

## **Neni 19**

Kur do të vërtetohet se diskutimi ka përfunduar, Kryetari dhe në mungesë të tij, Zëvendëskryetari, e mbyllë diskutimin dhe e formulon përfundimin e propozimit, për të cilin duhet të votohet.

Propozimi për të cilin votohet domosdoshmërisht të jetë i formuluar në mënyrë të qartë.

## **Neni 20**

Nëse ka propozim të kundërt nga ai që është shënuar në materiale, Kryetari dhe në mungesë të tij Zëvendëskryetari, e hedh në votim në fillim propozimin e kundërt, por nëse ka më shumë propozime vendosen në votim sipas rendit të propozuar.

## **Neni 21**

Votimi sipas propozimit bëhet në mënyrë publike, me ngritjen e dorës, nëse nuk vendoset që votimi të bëhet në mënyrë tjetër.

Anëtari i Këshillit mbikëqyrës mund të votojë për, kundër, ose të abstenojë (përmbahet) nga votimi.

Votimi “PËR”, “KUNDËR” dhe “ABSTENIM” konstatohet në procesverbal.

Anëtari i Këshillit mbikëqyrës ka të drejtë të japë mendimin ose qëndrimin e tij lidhur me propozimin që shqyrtohet, ose për të cilin votohet, të kërkojë të përfshihet në procesverbal.

### **3. Kuorumi për punë dhe vendimmarrje**

#### **Neni 22**

Këshilli mbikëqyrës mund të punojë dhe miratojë vendime nëse në mbledhje janë të pranishëm së paku gjysma e anëtarëve të tij.

Këshilli mbikëqyrës vendimet i merr me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Në rast të ndarjes së votave, vota e Kryetarit dhe në mungesë të tij, vota e Zëvendëskryetarit, vendosë.

#### **Neni 23**

Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës e lëshojnë mbledhjen dhe nuk marrin pjesë në miratimin e vendimeve nëse është vënë në pikëpyetje objektiviteti i tyre, për shkak të ekzistimit të konfliktit të interesit.

Në rast të ekzistimit të konflikteve të interesit, anëtarët e Këshillit mbikëqyrës, para mbajtjes së mbledhjes, japin deklaratë me shkrim deri te Këshilli mbikëqyrës dhe Këshilli drejtues i Bankës, ku theksohet baza nga i cili rrjedh konflikti mes interesit të tyre personal dhe interesit të Bankës.

#### **Neni 24**

Këshilli mbikëqyrës mund të vendosë dhe miratojë vendime edhe pa mbajtur mbledhje, nëse të gjithë anëtarët japin pëlqim me shkrim ndaj Propozim-vendimit, i cili miratohet.

Pëlqimi mund të jepet me nënshkrim-dora vetë, apo me nënshkrim të dërguar me faks ose në mënyrë elektronike për projekt-vendimin.

#### **Neni 25**

Vendimet e miratuara me pëlqim me shkrim të anëtarëve hyjnë në fuqi në ditën e dhënies së pëlqimit nga të gjithë anëtarët.

#### **Neni 26**

Për të gjitha vendimet e miratuara me pëlqimin e anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, përpilohet procesverbali, në të cilin evidentohen vendimet. Procesverbalin e nënshkruan Kryetari i Këshillit mbikëqyrës dhe në mungesë të tij, Zëvendëskryetari. Procesverbali për vendimet e miratuara vendoset në shqyrtim për anëtarët e Këshillit mbikëqyrës në mbledhjen e parë të ardhshme.

#### **Neni 27**

Vendimet dhe aktet tjera të miratuara nga Këshilli mbikëqyrës i nënshkruan Kryetari dhe në mungesë të tij, Zëvendëskryetari.

#### **Neni 28**

Vendimet e Këshillit mbikëqyrës të miratuara në mbledhje, hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre, përveç nëse nga vendimi nuk ka datë tjetër të fuqizimit të vendimit.

#### **Neni 29**

Vendimet dhe aktet e miratuara nga Këshilli mbikëqyrës, në kohë, i zbaton Këshilli drejtues i Bankës, kurse për moszbatimin e tyre është i detyruar menjëherë ta njoftojë Këshillin mbikëqyrës.

#### **Neni 30**

Pas përfundimit të mbledhjes së Këshillit mbikëqyrës, Drejtoria e administrimit dhe informimit i përgatitë dhe i dorëzon për zbatim vendimet dhe aktet e miratuara në afat jo më të gjatë se 5 (pesë) ditë.

#### **Neni 31**

Aktet nga neni paraparak, domosdoshmërisht duhet të përgatiten në pajtim me ligjet, Statutin dhe aktet tjera të Bankës.

### **4. Procesverbali nga mbledhja**

#### **Neni 32**

Për punën e Këshillit mbikëqyrës përgatitet procesverbal. Procesverbalin e përgatitë punëtori nga Drejtoria e administrimit dhe informimit, në afat prej 3 (tri) ditëve nga mbajtja e mbledhjes.

Procesverbali përmban të dhëna për kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, personat që kanë marrë pjesë dhe rendin e ditës, çështjet, të cilat kanë qenë subjekt i votimit dhe rezultatet nga çdo votim, duke përfshirë edhe emrat e anëtarëve, të cilët kanë votuar “për” dhe “kundër” vendimeve të miratuara në mbledhje.

Në procesverbal, mund që me kërkesë të anëtarit, i cili ka votuar “për”, ose “kundër”, të përfshihet edhe shkaku pse ka votuar në këtë mënyrë. Nëse ndonjëri nga anëtarët ka konflikt interesi, ka detyrim që në fillim të mbledhjes, kur do të shqyrtohet dhe vendoset për atë pikë të rendit të ditës, këtë ta paralajmërojë dhe ta lëshojë mbledhjen dhe e gjithë kjo të evidentohet në procesverbal.

Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e Këshillit mbikëqyrës, të cilët kanë qenë të pranishëm në mbledhje dhe Kryetari, përkatësisht në mungesë të tij, Zëvendëskryetari.

#### **IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 33**

Për zbatimin me sukses të dispozitave të kësaj Rregulloreje, kujdeset Kryetari dhe në mungesë të tij, Zëvendëskryetari i Këshillit mbikëqyrës.

##### **Neni 34**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje kryhen në mënyrën dhe procedurën e njëjtë si edhe gjatë miratimit.

##### **Neni 35**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja për punën e Këshillit drejtues të Bankës Komerciale SHA Shkup, nr.02-1610-12842 nga 31.03.2006.

##### **Neni 36**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

**KRYETARI I  
KËSHILLIT MBIKËQYRËS**

